



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina

---

**E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T**  
të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
23.04.2014, e cila filloi në orën 15:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës dhe u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Ekonomisë dhe Zhvillimit, Halim Halimi, kryesues, Sami Hamiti, Hazir Borovci, Ylli Hoxha, Hatixhe Hoxha dhe Islam Pacolli.

**Morën pjesë edhe:** Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore, Visar Berisha, drejtori i Drejtorisë së Financave dhe Pronës dhe përfaqësuesi i OSBE –së.

**Munguan :** Imer Rusinovci dhe Cuneyd Ustaibo.

Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi **Halim Halimi**, kryesues i komitetit.

Njëzëri u miratua ky

**REND DITE:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë;
2. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Barilevë;
3. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte;
4. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998 - 1999;
5. Propozimrregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme;
6. Propozimrregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore;
7. Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar - mars 2014;
8. Informatë për mbjelljet pranverore në komunën e Prishtinës;
9. Propozimvendimi për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në komunën e Prishtinës;
10. Raportet e komisioneve komunale të aksionareve të NPL-ve - diskutim;
11. Të ndryshme.

Para se të fillonin me diskutimet rreth pikave të rendit të ditës, **Ylli Hoxha** kërkoi që në mbledhjen e Kuvendit të jetë informata për vërshimet në komunën e Prishtinës.

## **Pika e parë**

**Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.**

## **Pika e dytë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Barilevë, kryesuesi tha se me këtë material jeni të njoftuar të gjithë, andaj dhe propozojmë që kjo pikë të procedohet më tutje.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Barilevë dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e tretë**

**Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte.**

**Islam Pacolli pyeti për vendndodhjen e këtij lokacioni që është paraparë për deponinë e mbeturinave inerte.**

**Sami Hamiti dha sqarime lidhur me këtë pronë.**

**Dardan Sejdiu tha se ky lokacion që është paraparë, është lokacioni më adekuat për deponinë e mbeturinave inerte.**

**Islam Pacolli kërkoi material shtesë për Kuvend.**

**Me një abstenim, u konstatua se u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për deponinë e mbeturinave inerte dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e katërt**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998 - 1999, informoi Agim Salihu, i cili tha se ky memorial është paraparë të ndërtohet në sipërfaqe prej 60 m<sup>2</sup>, duke llogaritur edhe sipërfaqen rreth këtij memoriali.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Memorialit në shenjë nderimi për kontributin e gruas gjatë periudhës së Luftës 1998 - 1999 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

## **Pika e pestë**

**Agim Salihu informoi lidhur me Propozimrregulloren për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme.**

Ai tha se komisioni ka punuar për këtë rregullore, e cila në Këshillin e Drejtorëve ka kaluar me plotësime dhe ndryshime që janë bërë.

**Sami Hamiti** tha se në nenin 2, pika 2.1 duhet të korrigohet; te neni 9, tha se Kryetari e ka për obligim dhënien e propozimit për vazhdimin e shfrytëzimit të pronës publike, ndërsa Kuvendi vendos; neni 9, pika 9.2 thuhet "të drejtën për vazhdimin e shfrytëzimit të përkohshëm e bën organi që ka nxjerr vendimin paraprak (DUNMM)", kjo nuk duhet të jetë kështu, (jo drejtoria), por të vazhdohet sipas dispozitave të ligjeve në fuqi. Po ashtu neni 13 dhe neni 14 duhet të korrigohen.

Sa i përket kësaj rregullore, në parim e mbështes.

**Dardan Sejdiu** kërkoi që nenin 9, paragrafët 9.2 dhe 9.3, mbetet që të analizohen edhe me Kryetarin.

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës publike për vendosjen e objekteve të përkohshme dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, por duke e lënë të hapur mundësinë që disa çështje të shqyrtohen me Kryetarin.**

#### **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Propozimrregulloren për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore,** informoi **Agim Salihu**. Ai tha se neni 2, pika 2.3 duhet të analizohet edhe një herë, të plotësohet ende.

**Ylli Hoxha** propozoi që neni 2, paragrafi 2.3, pika d të formulohet më mirë.

**Islam Pacolli** shprehu mendimin që t'i jepet prioritet atyre klubeve që japin kontribute në Komunën e Prishtinës.

**Dardan Sejdiu** tha se kjo rregullore mundëson lehtësimin e zhvillimit të veprimtarive të klubeve sportive të Komunës së Prishtinës.

**Islam Pacolli** pyeti lidhur me lejin e takimeve me qytetarë në objektet e shkollave publike. A ka ndonjë udhëzim administrativë që e përcakton këtë çështje?

**Kryesusi** tha se hapësirat e shkollave, sipas një udhëzimi administrativë të MASHT-it, lejohen të shfrytëzohen për të gjitha aktivitetet politike dhe jo politike, por vetëm gjatë fushatave zgjedhore.

**Dardan Sejdiu** theksoi se do t'ju njoftoj për këtë, pasi të konsultohem me Drejtorinë e Arsimit.

**Hatixhe Hoxha** kërkoi që neni 7.2 të jetë më i qartë.

**Kryesuesi** tha se te neni 8, pika c, të hiqet fjala "paga" dhe të zëvendësohet me "kompensim".

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimrregullorja për të hyrat vetanake të institucioneve arsimore dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

#### **Pika e shtatë**

**Për raportin financiar tremujor të periudhës janar - mars 2014, informoi Visar Berisha.**

Ai tha se raporti financiar tremujor paraqet informatën që ka të bëjë me pasqyrën e arkëtimit të të hyrave vetanake, shpenzimet dhe të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

Komuna e Prishtinës i ka arkëtuar gjithsej 3.504.886.37 € të hyra vetanake gjatë periudhës janar-mars, shumica e të hyrave janë nga taksat për leje ndërtimi dhe nga tatimi në pronën e paluajtshme. Komuna e Prishtinës ka planifikuar gjithsej 24,318,250.00 € të hyra vetanake për vitin 2014, prej të cilave në tremujorin e parë ka realizuar 14.41,%. Pjesa më e ulët e të hyrave është taksa për transaksion në pronë 19.1%. Komuna e Prishtinës ka shpenzuar gjithsej 8,019,473.75 € në tremujorin e parë të vitit 2014 për paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime, shërbime komunale, subvencione dhe projekte kapitale.

**Sami Hamiti** u shpreh se këtë raport e kemi analizuar dhe kemi konstatuar se ky raporti nuk i përmbush kërkesat, është dashur të analizohet dhe të përmbushet edhe më shumë. Po ashtu është dashur të zërthehet neni 45.4 i Ligjit nr. 03/L- 048, si dhe preambula të përcaktohet saktë (titulli është gabim, andaj duhet të përmirësohet). Shqetësuese është çështja e arkëtimit të mjeteve, sepse arkëtimi është i ulët në përgjithësi. Problem tjetër është niveli i të hyrave nga gjobat.

Ai kërkoi që për Kuvend raporti të jetë me këto plotësime dhe me material shtesë.

**Dardan Sejdiu** tha se si strukturim raporti është në rregull, por ka disa elemente që tregojnë se ritmi i arkëtimit vërehet pas tremujorit të parë. Ai u pajtua me vlerësimin se niveli i arkëtimit të mjeteve nuk është i kënaqshëm.

**Ylli Hoxha** shprehu bindjen se arkëtimi nga lejet e ndërtimit do të ketë ngritje.

**Islam Pacolli**, lidhur me investimet kapitale, sugjeroi që punët të kryhen mirë, e të mos përsëriten si në të kaluarën. Projektet që janë paraparë duhet të shkojnë përpara.

Ai pyeti se me taksën e ndërtimit a përfshihet infrastruktura e ndërtimit dhe çka përfshin taksa e dendësitetit.

**Agim Salihu** dha sqarime lidhur me taksën e dendësitetit.

**Hazir Borovci** u pajtua me vlerësimet e dhëna nga parafolësit, duke uruar që këta numra të ndërrohen pozitivisht në pjesën tjetër.

**Agim Salihu** tha se te pasqyra e arkëtimit të të hyrave vetanake, fjala "licencë" në biznes, të zëvendësohet me fjalën "taksë" në biznes.

**U konstatua se njëzëri u përkrah shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar - mars 2014, dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me plotësime dhe ndryshimet e paraqitura.**

**Pika e tetë**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Informata për mbjelljet pranverore në komunën e Prishtinës, e cila do të prezantohet në mbledhjen e Kuvendit.**

**Pika e nëntë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e komisionit për emërtimin e lagjeve, rrugëve dhe rrugicave në komunën e Prishtinës, Kryesusi tha se në mbledhje të Kuvendit do të sillen emrat e anëtarëve të komisionit.**

**U konstatua se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për caktimin e komisionit për emërtimin e lagjeve, rrugëve dhe rrugicave në komunën e Prishtinës dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

**Pika e dhjetë**

**Për raportet e komisioneve komunale të aksionareve të NPL-ve - diskutim, Dardan Sejdiu theksoi se deri tani janë sjellë pesë raporte të komisioneve komunale të aksionareve dhe pritet që në ndërkohë të sillen edhe raportet e tjera ( raportet nga NPL “Stacioni i Autobusëve” dhe NPL “Sport - Marketing”).**

**U konstatua se njëzëri u përkrah që raportet e komisioneve komunale të aksionarëve - diskutim, t’i dërgohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.**

**Të ndryshme**

U konstatua se njëzëri u përkrah që në Kuvend, në kuadër të pikës së rendit të ditës “Informatë për mbjelljet pranverore në komunën e Prishtinës”, të jetë edhe informata për vërshimet në komunën e Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 17:15.*

**Procesmbajtës :  
Zijadin Gashi  
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Halim Halimi, jur.i dipl.**